

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

Korçë me, 10.05.2023

STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE
“ DIVA TERRACE ” sh.p.k

Arian Zguri ,i biri i Theodhoraq i datelindjes 10.09.1970 , lindur dhe banues në Korçe , adresa : Lagjja 11, Bulevardi Republika, Objekti Nr. 16, Z.Kadastrale 8561 ,Nr pasurie 6/331 ,Korçe .
Shqiperi me Nr. ID H00910089F .


Hartojme Statutin e shoqërisë me përgjegjesi te kufizuar, sipas përcaktimeve të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar. Me nëshkrimin e këtij statuti, themeluesi mer përsipër të realizojë e të respektojë të drejta dhe detyrimet të mëposhtme:

KREU I
EMRI, ORTAKËT, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 1
Emërtimi i shoqërisë

1.1 Emri i shoqërisë është “ **DIVA TERRACE** ” sh.p.k
Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar si dhe emri i ortakut duhet të jenë të përmendura në të gjitha aktet dhe dokumentat që nxjerr kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve.

1.2 Shoqëria e emërtuar “ **DIVA TERRACE** ” sh.p.k (më poshtë e quajtur shoqëria) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e krijuar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.
Shoqëria është themeluar sipas ligjit Nr. 9901 , datë 14.04.2008 “ *Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare* ”, i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar Shqiptar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).



Page 1 of 12

"DIVA TERRACE" sh.p.k
Korçë
Shqipëri

NENI 2
Ortakët

Ortaku I vetem I shoqërisë " **DIVA TERRACE** " sh.p.k do të jete :

Arian Zguri ,i biri i Theodhoraq i datelindjes 10.09.1970 , lindur dhe banues në Korce , adresa Lagjja 11, Bulevardi Republika, Objekti Nr. 16, Z.Kadastrale 8561 ,Nr pasurie 6/331 ,Korce . Shqiperi me Nr. ID H00910089F , zotëron 100% (njëqind përqind) të vlerës së kapitalit të shoqërisë.

NENI 3
Selia

3.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Lagjja 11, Bulevardi Republika, Objekti Nr. 16, Z.Kadastrale 8561 ,Nr pasurie 6/331 ,Korce .

3.2 Shoqëria mund të hap zyra përfaqësimi, degë dhe/ose filiale të marrë pjesë në shoqëri të tjera, të kryejë aktivitete në vende të tjera , qoftë brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

NENI 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pakufizuar. Asambleja e Ortakëve mund ta kufizojë ose ta zgjasë afatin e veprimtarisë së Shoqërisë.

NENI 5
Vula

Shoqëria ka vulën me emrin e saj.

KREU II
OBJEKTI, KAPITALI, TRANSFERIMI I KUOTAVE

NENI 6
Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e aktiviteteve si më poshtë:

Page 2 of 12

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

- Bar , lokal evente me muzike

Çdo veprimtari tjetër që nuk ndalohet me ligj.

NENI 7
Kapitali

7.1 Kapitali themeltar i regjistruar i Shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) Leke i zotëruar nga ortakët i vetëm si më poshtë :

7.2 Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre si mëposhtë:

- Ortaku Themelues Arian Zguri me Nr. ID H00910089F , zotëron 100% (të vlerës së kapitalit themeltar, të shoqërisë, që përfaqëson 1 pjesë të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100.000 (njëqind mijë leke);

7.3 Kapitali është nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët e shoqërisë, sipas pjesëve përkatëse të përcaktuara.

7.4 Përgjegjësia e secilit ortak shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e shoqërisë.

7.5 Kapitali i shoqërisë mund të rritet në të ardhmen, nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së kuotave të reja nga ortakët e rinj, vetëm me vendim unanim të Asambles së Ortakëve , ku do të miratohet si rritja e kapitalit themeltar ashtu dhe hyrja e ortakëve të rinj. Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të gjithë ortakëve.

7.6 Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë do të realizohet duke u bazuar në dispozitat e veçanta që parashikohen nga Ligji 9901. date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

7.7 Kapitali i shoqërisë do të përbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros, detyrimet e ortakëve huara dhe instrumenta të tjera, dhe të tjera pasuri të nevojshme të luajtshme apo të paluajtshme për ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë.

Page 3 of 12

NENI 8

Transferimi i kuotave dhe e drejta e përparësisë

8.1 Kuotat e çdo anëtari përputhen me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e shoqërisë janë të transferueshme midis ortakëve të shoqërisë ose të tretëve në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të shoqërisë. Anëtarët e shoqërisë kanë përparësi për blerjen e kutoave përpara personave të tretë jashtë shoqërisë.

8.2 Nëse ndonjë nga ortakët dëshiron të transferojë ose të shesë një pjesë ose të gjitha kuotat e tij atëherë ai duhet t'i drejtojë një kërkesë me shkrim Administratorit duke saktësuar çmimin e shitjes, i cili duhet të jetë i arsyeshëm dhe të jetë i njëjtë me atë që do t'i ofrohet dhe një personi të tretë jashtë shoqërisë si dhe të dhënat e blerësit. Administratori jep përgjigje brenda 30 ditëve nga data e njoftimit dhe duhet t'ua transmetojë ortakëve të tjerë këtë kërkesë dhe ortakët e tjerë duhet të japin një përgjigje brenda 3 muajve. Edhe e drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave duhet të ushtrohet me shkrim duke ju drejtuar Administratorit.

8.3 E drejta e përparësisë për transferimin ose shitjen e kuotave është në propocion me kuotat që zotëron secili prej ortakëve në këtë shoqëri. Administratori pasi ka kaluar afati 3 muajsh, brenda 30 ditëve i komunikon ortakut që shet kuotat e tij vendimin e ortakëve të tjerë për të blerë të gjitha ose pjesërisht kuotat e tij.

8.4 Në rast se kuotat nuk shiten brenda shoqërisë, atëherë kuotat brenda 90 ditëve i ofrohen personave të tretë jashtë shoqërisë. Transferimi dhe shitja e kuotave duhet të bëhet me akte noteriale dhe një kopje e këtij akti duhet të depozitohet në librin e Ortakëve.

8.5 Të gjitha transferimet e kuotave kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kuotat me vlerë nominale 1.000 leke janë të pandashme. Në rastet e bashkëpronësisë vepron sipas ligjeve.


KREU III
ORGANET DREJTUESE
NENI 9

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

Shoqëria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ushtron aktivitetin e saj pas regjistrimit si subjekt tatim pagues.

Organet kryesore të Shoqërisë janë:

-Asambleja e ortakëve,

-Administratori

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshtë.

NENI 10
Asambleja e Ortakëve

10.1 Funksioni dhe Kompetencat :

10.1.1 Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e thirrur rregullisht, përfaqëson të gjithë Ortakët e shoqërisë dhe është organi më i lartë vendimarrës i shoqërisë. Në përputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendimet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:

- a) Percaktimin e politikave të biznesit;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e Administratorit (eve);
- c) Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël;
- d) Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- e) Zbatimin dhe miratimin e pasqyrave financiare për llogaritë vjetore, të administrimit dhe të raporteve të mbikëqyrjes;
- f) Miratimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve;
- g) Miratimin e shpërndarjes së fitimit vjetor;
- h) Miratimin e skemës së kompesimit për Administratorin, Likuiduesin, dhe ekspertët kontabël;
- i) Ristrukturim, prishjen, transformimin, bashkimin, likuidimin e shoqërisë ose riorganizimin e Shoqërisë në ndonjë formë tjetër Shoqërie;
- j) Marrjen e të gjitha masave me qëllim që të sigurohet që Shoqëria të ketë kapital dhe asete të mjaftueshme për ushtrimin e aktiviteti dhe përmbushjen e detyrimeve kundrejt të tretëve ;
- k) të hipotekojnë, lenë peng dhe vendosin çdo barrë mbi astetet e veta dhe të lidhin çfarëdo marrëveshje financiare me çdo palë financuese, me kusht që

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

hipoteka , pengu apo barrët e tjera, po ashtu si dhe marrëveshjet përkatëse financiare, të shërbejnë për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 4;

l) Krijimin, mbylljen dhe/ose prishjen e degëve, zyrave të përfaqësimit dhe filialeve;

o) çdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji dhe nga ky statut;

10.1.2 Çdo Ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë, me të drejtën e votës në raport me numrin e kuotave të zotëruara në kapitalin e Shoqërisë. Çdo ortak mund të përfaqësohet në vendimarrje nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti(ja) ose nga çdo person tjetër, me kusht që përfaqësuesitë jenë të pajisur me prokurë për këtë qëllim.

10.2 Thirrja e Asamblese

10.2.1 Administratoret, sipas gjykimit të tyre të lire ose me kekesen e një dhe/ose me shumë Ortakeve të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të kapitalit të Shoqërisë , dhe/ose eksperti kontabel i autorizuar , nëse ka, dhe/ose likujduesit kanë të drejtë të therrasin Asamblyne e Përgjithshme të Ortakeve.Ortakeve duhet t’u dergohe një njoftim me shkrim për mbledhjen me ane të postës së regjistruar apo me e-mail, jo më pak se 7 dite përpara datës së mbledhjes, që përmban të dhënat për arsyen e mbledhjes, vendin, datën dhe orën e saj.

10.2.2 Verifikimi i njoftimit të mbledhjes nuk është i nevojshëm nëse të gjithë Ortaket janë të pranishëm apo janë të përfaqësuar , në përputhje me nenin 10.2.1.

10.3 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

10.3.1 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, statuti dhe sa herë është e nevojshme për të mbrojtur interes të shoqërisë.

10.3.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet nëse:

a) rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare;



“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

c) shoqëria , brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

10.3.3 Asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

10.3.4 Asambleja e përgjithshme mund të zhvillohet në selinë e shoqërisë, ose online pas realizimit të komunikimit në adresën elektronike të dhënë nga ortakët.

10.4 Kuorumi

10.4.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

10.4.2 Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike.

10.5 Marrja e vendimeve

10.5.1 Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës në rastet kur kërkohet :

- a) ndryshimi i statutit,
- b) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar,
- c) shpërndarja e fitimeve riorganizimi,
- d) prishja e shoqërisë.

10.5.2 Me përjashtim të rasteve të parashikuara sa më sipër në pikën 10.5.1, për të gjitha pikat e tjera të përcaktuara në pikën 10.1.1, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.


NENI 11
ADMINISTRATORI

Page 7 of 12

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

11.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një Administrator i vetëm që është Arian Zguri ,i biri i Theodhoraq i datelindjes 10.09.1970 , lindur dhe banues në Korçe , adresa : Lagjja 11, Bulevardi Republika, Objekti Nr. 16, Z.Kadastrale 8561 ,Nr pasurie 6/331 ,Korçe . Shqiperi me Nr. ID H00910089F .

11.2 Administratori i vetëm do të qëndrojë në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare nga dita e depozitimit të statutit në QKB, përjashtohet ky afat nga vendimet e asamblese që ju jepet e drejta ta largojne para ketij afati per arsye thelbesore.

NENI 12
Kompetencat e administratorit

12.1 Administratori i vetëm i Shoqërisë ka të drejtë e detyrohet të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë.Ai ushtron të gjitha kompetencat sipas përcaktimeve të nenit 95 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

12.2 Administratori i vetem i ka te gjitha te drejtat e fuqite per drejtimin e zakonshem te Shoqerise, me qellim arritjen e objektivave te saj.

12.3 Administratori i Shoqërisë ka të drejtë të emërojë përfaqësues të posaçëm dhe të delegojë kompetencat e tij.

12.4 Administratorit te vetem i takon firma e lire dhe perfaqesimi i Shoqerise ndaj te treteve ne veprime, procedura dhe seance gjyqesore, si dhe pajtime dhe kompromise, pasi te kete marre vendimin e Asamblese.

12.5 Administratori eshte pergjegjes, sipas rastit ndaj shoqerise ose te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo deme te kryera gjate ushtrimit te detyres.

12.6 Kompetencat kryesore te Administratorit te shoqerise jane:

a) Te hartoje planet e llogarive ekonomike.

Page 8 of 12

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

- b) Te hartoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- c) Te perfaqesoje Shoqerine me te tretet ne te gjitha veprimtarine e saj.
- d) Te percaktoje strukturat e aparatit te shoqerise dhe te krijojë organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektiveve te Shoqerise.
- e) Te perzgjedhe ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likuidimit.
- f) Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
- g) Te vendose rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), etj;
- h) Te perfaqesoje shoqerine ne regjistrin e prones sipas ketij statuti.
- i) Te mbikqyrë dhe te zbatoje veprimtarite dhe politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e Asambles se Ortakeve ;
- j) Me kerkese te asambles se ortakeve , te ndermarrë masa te cilat jane kompetencë e kesaj te fundit, te propozoje vendimet qe do te miratohen nga Asambleja e ortakeve dhe t'i zbatoje keto vendime ;
- k) Të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin e zbatueshem dhe standartet kontabel;
- a) Të kryejë te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar te Shoqerise;
- b) Të sigurojë dokumentet dhe librat kontabel te Shoqerise te mbahen ne rregull dhe me saktesi;
- c) Të thërrasë një mbledhje te Asambles se Pergjitheshme kur e vlersojne te nevojeshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
- d) Të pergatise dhe nenshtuaj pasqyrat financiare vjetor te Shoqerise, pasqyrat financiare te konsoliduara, te cilat bashke me propozimin per shpernadarjen e fitimit i paraqiten per miratim Asambles se ortakeve;
- e) Të kryej te gjitha regjistrimet dhe publikimet e deyrueshme ne lidhje me Shoqerine , sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem;
- f) Të miratoje hapjen e cdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre;

KREU IV
KUSHTET EKONOMIKE
NENI 13

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri; mund të blejë, të

Page 9 of 12

“DIVA TERRACE” sh.p.k
Korçë
Shqipëri

shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barrë për detyrime ndaj të tretëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 14

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhese, si dhe librin e saj të llogarive në baze të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në baze të kriterëve të caktuar nga Banka e Shqipërisë.

NENI 15

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisën; vitin e parë në momentin e regjistrimit në QKR dhe në organet tatimore e mbyllën në 31 dhjetor të po atij viti, ndërsa vite të tjera në 1 Janar dhe mbyllën në 31 Dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve në fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore, gjashtëmujore) miratohen e nënshkruhen nga administratori i shoqërisë. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakeve e nënshkruhen nga administratori dhe depozitohen në QKR e në Tatim Taksë. Llogaritë vjetore, inventaret, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta të hartuara nga Administratori dhe eventualisht ekspertit kontabel i autorizuar, miratohen nga ortaket.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda 3 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert Kontabel i Autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhjeje, nga ortaket.

Shkarkimi i Ekspertit Kontabel të Autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se verëhen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

NENI 16

Fitimi neto i realizuar, pasi janë zbritur rezervat ligjore deri 5% të fitimit të cilat do të krijohen në shoqëri deri shumën 10% të kapitalit dhe tatimet mbi fitimin, mbetet në përdorim të ortakeve të cilët vendosin për përdorimin e tij.

NENI 17

"DIVA TERRACE" sh.p.k
Korçë
Shqipëri

Ne rastet kur ortaket jane debitore per kapital te paderdhur sipas % te pjesemarrjes ne kapital, fitimi neto do te kaloje per shlyerje te detyrimit deri ne masen e plotesimit te % te pjesemarrjes.

KREU V
MARRËDHËNIET E PUNËS

NENI 18

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert zgjidhja behet ne gjykaten shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

KREU VI
DISPOZITA TË VEÇANTA
NENI 19

Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfaredo lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privim te drejtave per te ushtruar aktivitet tregetar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket. Shoqeria hyn ne fazen e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi, Ortaket emerone nje ose disa likujdatore, te cilet i paraqesin atij raportin mbi gjendjen e Aktivitetit dhe Pasivitetit te Shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likujdimit dhe afatin e nevojshem te perfundimit te tyre. Ne fund te procesit te likujdimit, Ortaket vendosin mbi Bilancin perfundimtar financiar. Mbi aktin e rregullshmerise se punes se likujduesit dhe mbyllje si pjese e likujdimit. Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeve te kapitalit themeltar tek kontribuesi perkates, likujdatori ndan kapitalet e mbetura per ortaket.

NENI 20

"DIVA TERRACE" sh.p.k
Korçë
Shqipëri

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në shoqëri me të tretët, zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 21

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit themelimit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, Tiranë, në bazë të ligjit nr.9723 datë 03.05.2007.

NENI 22

Për sa nuk është parashikuar në këtë Statut do të bëhet referim ligjit Nr 9901 datë 14/04/2008 "Për Tregetaret dhe Shoqërishte Tregetare", i ndryshuar si dhe legjislacionit koherent. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë me të cilën nxirret vete statuti.

NENI 23

Ky statut u përpilua nga Ortaku themelues duke shprehur vullnetin e tij të plotë e të lirë.

Ai u përpilua në katër kopje autentike, një kopje për t'u depozituar në QKB nga një kopje për secilin prej ortakëve dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

" DIVA TERRACE " sh.p.k

ORTAKU I VETEM

Arian Zguri

